



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:049797
Datë: 30.06.2023
Numri i dokumentit: 04439960

APS.nr.23/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- Departamenti Special, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ferit Osmani – kryetar i kolegjit, Vaton Durguti- gjyqtar referues, Burim Ademi – anëtar i kolegjit, si dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Endrit Ajeti, në çështjen penale ndaj të akuzuarit H.P, për shkak të veprave penale, Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, Mashtrimit në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale Shpëlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ankesën e të pandehurit H.P, si dhe ankesën e përbashkët e mbrojtësve të të akuzuarit av. Feim Alaj, e av. Durim Osmani, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.36/2020, të datës 10.01.2023, dhe përgjigjes në ankesë e mbrojtësit av.Durim Osmani, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPRK-së, më datë 05.06.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, e të akuzuarit H.P dhe ankesa e përbashkët e mbrojtësve të të akuzuarit av. Durim Osmani dhe av.

Feim Alaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, PS.nr.36/2020, datë 10.01.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.36/2020, të datës 10.01.2023, të akuzuarin H.P, e ka shpallur fajtor për veprat penale, Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, Mashtrimi në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale Shpëlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe e ka gjykuar me dënim si në vijim:

-
- Për shkak të veprës penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej 10,000 € (dhjetëmijë/euro).
- Për shkak të veprës penale Mashtrimi në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej 5,000 € (pesëmijë/euro) si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve.
- Për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK- së, e gjykon dënim me gjobë në lartësi prej 2,000€ (dymijë/euro).
- Për shkak të veprës penale Shpëlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej 25,000€ (njëzetepesë mijë/euro) si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite.

Konform dispozitës së nenit 80 par. 1 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit **H.P** i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje **prej 4 viteve e 6 gjashtë muajsh** si dhe dënimin unik me gjobë në lartësi prej **42.000€ (katër dhjet e dy mijë/euro)** të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e gjykatës në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, të njëjtin gjykata do ta zëvendësoj me dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 (njëzet) euro, me 1 (një) ditë burgim.
- Koha e kaluar nën masën e paraburgimit dhe atë nga dt. 16.11.2018 e deri më dt.15.03.2019, si dhe nga dt. 26.07.2019 e deri më dt. 22.01.2020, i ka llogaritur në dënimin e shqiptuar me burgim.
- Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, armët dhe atë: një pistolet të tipit "Girsan" të kalibrit 9mm me numër serik ---, me dy karikator si dhe 166 fishek të të njëjtit kalibër, si dhe një pushkë gjuetie të tipit "Super Champion" me numër serik 111238 dhe 55 fishek, i ka konfiskuar.
- Në bazë të nenit 62 par. 1 dhe 2 nënpar 2,6 të KPRK-së, krahas dënimit kryesor, të njëjtit i ka shqiptuar dënim plotësues, dhe atë konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, siç janë:

-

Pasuria e luajtshme: Vetura e tipit "Mercedes", ngjyrë hiri me targa ----, me numër të shasisë WDD, viti i prodhimit 2019, i regjistruar në emër të Auto Sallonit Prishtina. Vetura e tipit "Skoda", me ngjyrë të zezë me targa ----, me numër të shasisë -----, viti i prodhimit 2014, e regjistruara në emër të U.P. Vetura e tipit "Vë Golf", ngjyrë e zezë me targa RKS, me numër të shasisë -----, viti i prodhimit 2015 e regjistruar në emër të M.M. Vetura e tipit "Audi A7", ngjyrë e bardhë me targa RKS, me numër të shasisë XXX, viti i prodhimit 2018, në pronësi të H.P. Vetura e tipit "Land Rover", me targa XXX, ngjyrë të kaltër, me numër të shasisë, XXX, viti i prodhimit 2018 e regjistruar në emër të F.P. Vetura e tipit "Renault Megan", ngjyrë të bardhë me targa KS me numër të shasisë XXX, viti i prodhimit 2018 e regjistruar në emër të U.P. Vetura e tipit "VW TOURAN", ngjyrë e kaltër me targa XXX, me numër të shasisë XXX, viti i prodhimit 2016 e regjistruar në emër të H.P. Vetura e tipit "VW Golf", ngjyrë e zezë metalike me targa XXX, me numër shasisë XXX viti i prodhimit 2009, i regjistruar në emër të H.P., konfiskohet.

Pasuria e paluajtshme: Ngastra kadastrale me numër 000 me sipërfaqe të përgjithshme prej 000 m², në zonën kadastrale Lubizhdë Komuna Prizren, në të cilën janë ndërtuar objekte afariste me sipërfaqe prej 1072 m², të regjistruara në emër të H.P. Ngastra Kadastrale e evidentuar me numër të njësisë kadastrale P-000 në sipërfaqe prej 000 m² ZK Prizren

përkatësisht 000 m² oborr dhe 000 m² shtëpi. Ngastrën kadastrale me nr. 000 me sipërfaqe të përgjithshme prej 95 m², në zonën kadastrale Pejë e regjistruar në emër të H.P . Ngastrën kadastrale me nr.000 me sipërfaqe të përgjithshme prej 0000 m², e cila gjendet në zonën kadastrale Prizren e regjistruar në emër të A.SH. Dy lokale në ngastrën kadastrale 000 në sipërfaqe prej 174 m², dhe 92 m², zona kadastrale në Prizren në lagjen Atmejdan rruga Tirana tek ‘LBP ’ të regjistruar në emër të H.P , konfiskohet, kurse pas plotfuqishmërisë së aktgjykimi ka obliguar që Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë, t`i marr nën administrim dhe menaxhim pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme dhe ti administroi në përputhje me ligjin mbi agjencinë.

Në kuptim të nenin 116 të KPRK-së, sendet e sekuestruara përkohësisht dhe atë ngastra kadastrale me nr.000, me sipërfaqe të përgjithshme prej 000 m² në vendin e quajtur Atmejdan ZK Prizren e regjistruar në emër të tij me pronësi prej 5/8, ndërsa në emër të B.SH me pjesë të pronësisë prej 3/8, ka urdhëruar që të **lirohen**.

- Palët e dëmtuara B.K , B.K , F.S, M.B , H.SH , D.Z , Z.M , R.L , lidhur me kërkesën pasurore juridike i ka udhëzohet në kontestin e rregullt civil.
- Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t`ia kompensoi shumën prej **500 euro**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **100 euro**, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave shumën prej **100 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokuroria Themelore në Prishtinë, departamenti Special, për shkak të vendimit lidhur me dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi ankesën, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PS.nr.36/2020, të datës 10.01.2023 ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënime më të ashpëra.

Mbrojtësit e të akuzuarit H.P av. Durim Osmani dhe av. Feim Alaj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike, si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e

aktgjykimit, me propozim që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, të datës 06.04.2023, me shenjë PS. Nr.36/ 2020 te prishet dhe çështje te kthehet ne rivendosje dhe rigjykim ose te ndryshohet aktgjykimi dhe i dyshuari H.P te lirohet nga te gjitha pikat e aktakuzës si dhe pasuria e tundshme dhe e patundshme e konfiskuar te lirohet.

I akuzuari H.P , pa precizuar bazat ankimore, me propozim që lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ne shkallën e parë, që në mënyrë të drejtë dhe të ligjshëm të shtjellohen të gjitha faktet dhe provat, ashtu që e njëjta gjykatë të nxjerrë aktgjykim lirues.

Përgjigje në ankesë të PSRK-së, ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit H.P av. Durim Osmani, , me propozim që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, departamenti Special, të refuzohet si e bazuar.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.248/2023, datë 11.05.2023 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamenti Special, PS.nr.36/2020 (2020:049797), të dt. 10.01.2023, ashtu që aktgjykimin ta ndryshoj dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënime më të ashpëra. Të refuzohen si të pabazuara ankesa e të akuzuarit H.P dhe ankesa e përbashkët e mbrojtësve të akuzuarit av. Durim Osmani dhe av. Feim Alaj, si dhe të refuzohet si e pabazuar përgjigja në ankesë e PSRK-së, e ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit av. Durim Osmani.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit më datë 05.06.2022 konform dispozitës të nenit 390 par. 1 të KPPRK-së, në të cilën ishin prezent, i akuzuari H.P , mbrojtësit e të akuzuarit av. Durim Osmani, e av. Feim Alaj, i dëmtuari D.Z , dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar Z.M av. Egzon Lajqi, ndërsa nuk ka prezantuar askush nga Prokuroria e Apelit, të dëmtuarit B K, B.K , F.S, M.B , H.SH , Z.M , e R.L , edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt.

I akuzuari H.P , dhe mbrojtësit e tij av. Durim Osmani dhe av. Feim Alaj deklaruan se në tersi mbeten pranë ankesave dhe pretendimeve të tyre, të cilat pretendime i mbështeti edhe i akuzuari në tërësi, kurse i dëmtuari D.Z , dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar Z.M av. Egzon Lajqi, kanë deklaruar se paraqesin kërkesë pasurore juridike ndaj të akuzuarit.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës në këtë çështje së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 par.1 të KPRK-ës, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuara në ankesa, gjeti se: **Ankesat janë të pabazuara.**

Pretendimet ankimore:

Prokuroria Speciale në ankesë pretendon se lartësia e dënimit në rastin konkret nuk i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale, e as shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit, kështu që me dënimet e shqiptuara nuk do të arrihet qëllimi i dënimit në pajtim me nenin 34 të KPRK-së, nuk do të arrihet rehabilitimi i të akuzuarit, e as efekti i përmbajtjes së personave tjerë që të mos kryejnë veprë penale. Kësisoj rrethanave lehtësuese i është dhënë rëndësi tepër e madhe, kurse ato rënduese fare nuk janë vlerësuar, kështu gjykata e shkallës së parë fare nuk ka vlerësuar këmbgulësin si rrethanë rënduese.

Mbrojtësit e të akuzuarit H.P av. Durim Osmani dhe av. Feim Alaj pretendojnë se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj ka bërë tejkalim të aktakuzës, sepse me aktgjykimin e saj ka tejkualuar piken I. sa i përket veprës penale Ushtrim i Kundërligjshëm i Veprimtarisë Mjekësore te aktakuzës (neni 262 te KPK -së) në dëm të të pandehurit, dhe në kundërshtim me nenin 360 paragrafi 1. lidhur me nenin 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 te KPPK-së. Kështu nëse analizohet aktakuza I. i ndryshuar dhe dispozitivi I. i aktgjykimit të shkallës së parë, mund të vërehet ndryshime në elementet subjektive dhe objektive në mes këtyre akteve juridike, nga ana e gjykatës tejkalimi i aktakuzë është bërë në dëm të pandehurit, dhe nuk paraqet vetëm shtim i disa detajeve nga faktet e gjykuara, të cilat nuk e ndryshojnë thellësisht aktakuzën. Në aktakuzën e ndryshuar te datës 24.12.2022 prokuroria e akuzon te mbrojturin tim se ka dëmtuar H.SH dhe F.S dhe "jo persona te ndryshme", ne këtë aktakuzë te ndryshuar i mbrojturi im nuk akuzohet se përmes regjistrimit te biznesit ka kryer veprë penale, por, që nga regjistrimi i biznesit ka kryer veprimtari mjekësore përmes "...si këshillim i te dëmtuarës H.SH që të pike dhe të përdor ne ushqim lëngun me përmbajtje te pidentifikuar, me ngjyrë të verdhe, të përgatitur nga ana e te akuzuarit apo këshillimi që të mos kërkoj ndihmë mjekësore si në rastin e te dëmtuarit - dëshmitarit F.S...", po ashtu, në dispozitivin e aktakuzës së ndryshuar nuk pretendohet se i mbrojturi im ka përfituar nga vepra penale nga neni 262 te KPK -së, por, pretendohet se ka kryer trajtime "mjekësore te autorizuara dhe te dëmshme". Gjithashtu, gjykata jo vetëm që ka bërë tejkalimin e aktakuzës, e njëjta ka "tejkualuar" shpalljen e aktgjykimit të datës 10.01.2023, p.sh në shpallje konfiskohen e gjithë pasuria e patundshme dhe jo e tundshme, ndërsa, në faqen

aktgjykimit ka liruar parcelën me shenj 000, me sipërfaqe prej 000 m2, në vendin e quajtur Atmejdani në Prizren.

Shkelja e ligjit penal ekziston nga fakti se gjykata sa i përket pikës I dhe II të aktakuzës, në pajtim me nenin 385 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP, për veprat penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe veprës penale Mashtrimi në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së është arritur afati relativ dhe absolut i ndjekjes penale. Kështu afati relativ i parashkrimit është arritur për veprën penale ushtrimi i veprimtarisë mjekësore, në lidhje me D.Z, ngase, vepra penal supozohet se ka ndodhur me date 21.03.2014, H.SH , ngase, vepra penale supozohet se ka ndodhur me datë 2011 deri në vitin 2012, B dhe B.K , ngase, vepra penale supozohet se ka ndodhur në vitin 2016, në anën tjetër hetimeve kanë filluar me date 17.08.2018, përmes aktvendimit të Prokurorisë Themelore në Prizren, me shenj PP/II nr. 2966 - 8/18, gjegjësisht, hetimet kanë filluar pasi është arritur afati 2 vjeçar i parashkrimit, kurse afati absolut i parashkrimit është arritur për veprën e supozuar penale të ushtrimit të kundërligjshme të veprimtarisë mjekësore përkitazi për palën e dëmtuar M.B , vepra penale supozohet se ka ndodhur në vitin 2017, R.L vepra e supozuar penale pretendohet se ka ndodhur me date 09.10.2018, B.K , vepra e supozuar penale pretendohet se ka ndodhur me date dt. 19.09.2018, F.S vepra e supozuar penale pretendohet se ka ndodhur me date 16.01.2018, Z.M vepra e supozuar penale pretendohet se ka ndodhur me date 19.05.2017, M.B , vepra e supozuar penale pretendohet se ka ndodhur me date vitin 2017, nëse llogaritet data 23.12.2022 nga data e fundit me e afërme e kryerjes së veprës penale e që është data 09.10.2018, rezulton se kanë kaluar më shumë se 4 vite që paraqet afatin absolut të parashkrimit të kësaj vepre penale.

Afati relativ i parashkrimit është arritur edhe për veprën penale Mashtrimi, në lidhje me D.Z , ngase, vepra penal supozohet se ka ndodhur me date 21.03.2014, H.SH , ngase, Vepra penale supozohet se ka ndodhur me date 2011 deri në vitin 2012, B dhe B.K , ngase, Vepra penale supozohet se ka ndodhur në vitin 2016, në anën tjetër hetimeve kanë filluar me date 17.08.2018, përmes aktvendimit të Prokurorisë Themelore në Prizren, me shenjën PP/II nr. 2966 - 8/18, gjegjësisht, hetimet kanë filluar pasi është arritur afati 2 vjeçar i parashkrimit. Afati absolut i parashkrimit është arritur për veprën e supozuar penale mashtrimi përkitazi për palën e dëmtuar M.B , vepra penale supozohet se ka ndodhur në vitin 2017, R.L vepra e supozuar penale pretendohet se ka ndodhur me date 09.10.2018, B.K , vepra e supozuar penale pretendohet se ka ndodhur me date dt. 19.09.2018, F.S vepra e supozuar penale pretendohet se ka ndodhur me date 16.01.2018, Z.M vepra e supozuar penale pretendohet se ka ndodhur me date 19.05.2017, M.B ,

vepra e supozuar penale pretendohet se ka ndodhur me date vitin 2017, nëse llogaritet data date 23.12.2022 nga data e fundit me e afërme e kryerjes se veprës penale e qe është data 09.10.2018, rezulton se kane kaluar me shume se 4 vite qe paraqet afatin absolut te parashkrimit te kësaj vepre penale. Andaj duke marr parasysh te lartcekurat rezulton se ne mënyre thelbësore te arsyetuar se sa i përket pikës 1 dhe 2 te aktakuzës është arritur afati absolut i parashkrimit sa i përket ndjekjes penale ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe mashtrimit. Në këtë kuptim gjykata ka bere shkeljen e ligjit penale dhe shkelje te dispozitave te procedurës penale, sa i përket llojit te aktgjykimit (vendimit gjyqësor) qe ka nxjerr si rrjedhoje.

Konstatimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, lidhur me veprën penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, eksiton për faktin se nëse analizohen provat materiale, i mbrojturi im nuk ka kryer trajtime mjekësore, ky përfundim mund te arrihet ne baze te provave që gjenden ne dosje te çështjes penale, përfundimi i gjykatës në këtë pjesë të arsyetimit të saj është kontradiktor me provat materiale dhe të vërtetën materiale, në atë forme që arsyetimi i aktgjykimit është kontradiktor me provat materiale dhe rrjedhimisht i njëjti nuk është përpiluar ne formën e përcaktuar me kod. Nga te lartcekurat rezulton se vetëm regjistrimi i aktivitetit mjekësor ne aktivitetin biznesor nuk inkriminohet (regjistrimit paraqet vepër kundërvajtje), por, inkriminohet kryerja e aktiviteve te trajtimeve mjekësore. Gjithashtu gjykata dhe prokuroria kanë bërë aplikimin e gabuar te dispozitave te kodit penale, sa i përket cilësimit se në rastin konkret, tek vepra penale nga neni 262 te KPRK-së është kryer në vazhdimësi. Në rastin konkret nuk kemi te bëjmë me vepra penale qe janë kryer në vazhdimësi, ne kuptim te nenit 81, ngase, vepra penale ushtrimit të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore nuk supozohet se është kryer ndaj personit të njëjtë, por personave te ndryshëm, siç janë: H.SH , F.S, ne atë formë qe kushtet procedurale për tu konsideruar kjo vepër penale se është kryer në vazhdimësi nuk janë plotësuar, gjegjësisht, nuk është plotësuar paragrafi 2 i nenit 81 te Kodit te Procedurës Penale te Kosovës, i cili cakton " Veprat penale të kryera kundër personit mund te konsiderohen si vepër penale në vazhdim vetëm nëse janë kryer kundër të njëjtit person..."

Sa i përket veprës penale Mashtrimit në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, nuk qëndron përfundimi i gjykatës se i mbrojturi im H.P i ka vene ne lajthim palët e dëmtuar ne fakte te caktuar, por, ndërveprimi ka pasur te beje me rituale te natyrës fetare, po ashtu, nuk qëndron fakti se te njëjtit kane besuar ne aftësitë "mbinatyrore te mbrojturit im", por, ne cilësitë e caktuar te ritualeve dhe ndikimin e këtyre ritualeve ne jetën sociale dhe gjendjen

shpirtërore te palëve. E gjithashtu në rastin konkret nuk kemi te bëjmë me vepra penale qe janë kryer ne vazhdimësi, ne kuptim te nenit 81 ngase, vepra penale mashtrimit nuk supozohet se është kryer ndaj personit te njëjtë, por personave te ndryshëm siç janë : D.Z , Z.M H.SH , F.S, R.L , B.K , B K, I.N , M.B , ne atë formë që kushtet procedurale për tu konsideruar kjo vepër penale se është kryer ne vazhdimësi nuk janë plotësuar, gjegjësisht, nuk është plotësuar paragrafi 2 i nenit 81 te Kodit te Procedurës Penale te Kosovës, i cili përcakton, citoj " Veprat penale të kryera kundër personit mund të konsiderohen si vepër penale në vazhdim vetëm nëse janë kryer kundër të njëjtit person ...". Ndërkaq lidhur me veprën penale Shpëlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.05/L-096, gjykata në kundërshtim me provat materiale ka konstatuar se i njëjti ka kryer këtë vepër penale, ngase element i figurës se veprës penale e shpëlarjes së parave është kryerja e një vepre tjetër penale për te cilën parashihet dënimi me afat burgosje deri ne 10 vjet ose me gjobë ne lartësi prej tri here me vlerën e pasurisë qe është subjekt i veprës penale. Vepra penale e pastrimit te parave kërkon qe te ekzistoj një vepër tjetër e ndërlidhur penale, nga e cila ka rrjedhë pasuria e kundërligjshme, ajo vepër penale sipas aktakuzës së ndryshuar është vepra penale e Mashtrimit, ndërsa, sipas aktgjykimit është vepra penale e Ushtrimit te kundërligjshëm të Veprimtarisë Mjekësore (kjo paraqet rrethanën e tejkalimit te aktakuzës), vepra e ndërlidhur penale duhet te ketë elementin e përfitimit si pjese e figurës se veprës penale, ne anën tjetër vepra penale nga neni 262 elementin e përfitimi nuk e ka pjese te figurës se veprës penale, ne këtë kuptim gjykata ka bere shkelje te ligjit penal dhe kodit te procedurës penale sa i përket pikës V te aktakuzës.

Sa i përket provave të pa pranueshme, gjykata e ka bazuar aktgjykimin në provë të pa pranueshme, gjë që e bënë aktgjykimin e nxjerr me shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale, ne kuptim te nenit 380 te Kodit te Procedurës Penale (kodi i procedurës qe eshë aplikuar ne kohen e zhvillimit te procedurës penale). Gjykata me date 22.03.2022 ka bere leximin e Deklarata e dëshmitarit B.K e dhënë në prokurori me dt. 07.12.2018; deklarata e dëshmitarit M.K e dhënë ne polici me dt.22.01.2019 dhe deklarata e dëshmitarit F.C ne polici me dt.12.09.2019, ngase B K, i cili ka njoftuar gjykatën përmes parashtrere se datës 14.09.2021 jeton ne Zvicër dhe se nuk mund te marr pjese ne seance dhe se mbes pran deklaratës paraprake te dhëne me date 07.12.2018, dëshmitari M.K , i cili ka vdekur dhe s' ka mundur te prezantoj me date 22.03.2022, dhe dëshmitari F.C për shkak se i njëjti me parashtrësën e datës 22.10.2021 e ka njoftuar gjykatën se jeton ne boten e jashtme dhe se nuk mund te prezantoj (procesverbali i shqyrtimit kryesor te çështjes i datës 22.03.2022), kurse në seancë mbrojtja ka kundërshtuar leximin e këtyre deklaratave, andaj deklaratat e dëshmitarëve të cilat në këtë çështje penale, janë

dhënë ne formë të "marrjes ne pyetje në procedurë paraprake" nuk mund të lexohen, sepse një gjë e tillë do të binte ndesh me dispozitat e KPP (Kodi 08/L-032). Gjykata gjithashtu ka bazuar aktgjykimin në provë të pa pranueshme, i cili është Kontrolli i datës 16.11.2018, që është bërë në kundërshtim me nenin 110.6, nenin 103 dhe 104 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kontrolli është bërë nga zyrtari Policor B.Z dhe prokuroret P.K dhe F.K , pa pasur aktvendim për fillim të hetimeve (Aktvendimi për Fillim të Hetimeve e ka datën 17.11.2018), në procesverbalin e datës 16.11.2018 ceket emri i prokuroreve F.K dhe P.K (dy prokuror në një çështje penale është e palejuar, ngase për një çështje penale caktohet një prokuror, përveç nëse përjashtohet), mirëpo në këtë date nuk ka pasur aktvendim për fillim të hetimeve, pra në kundërshtim me nenin 103 paragrafi 2 i KPP-së. Tutje ka shtuar se organi akuzues nuk ia ka dorëzuar provat materiale, edhe pse mbrojtja me date 04.05.2022 në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes ka kërkuar nga gjykata dhe organi i akuzës që të dorëzojnë provat materiale që nuk i janë dorëzuar mbrojtjes në asnjë fazë të procedurës penale, gjegjësisht, 4 librat me shënime, CD-ja e incizimeve të paautorizuara, mirëpo, e njëjta ka refuzuar që t'ia dorëzojë. Gjithashtu mbrojtja më datë 31.01.2022 në formë të shkruar dhe procesverbalin e datës 22.03.2022 ka propozuar, dëgjimin e ekspertit SH.B , me qëllim të elaborimit verbal dhe direkt të ekspertizës së datës 28.03.2019, përkitazi me të hyrat material dhe financiare të të pandehurit, si dhe dëgjimin e ekspertit të sociologjisë dr. I.H , i cili ka për detyrë që të sqaroj pranë gjykatës për besimet popullore në Ballkan dhe Kosovë, por gjykata sa i përket këtyre propozimeve, me date 22.03.2022 ka nxjerr aktvendim në baze të cilit ka refuzuar të gjitha këto propozime të mbrojtjes, kështu refuzimi i këtyre provave është në kundërshtim me nenin 258 të KPP-së.

Sa i përket konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, mbrojtësit e të pandehurit kanë pretenduar se, vlera e kësaj pasurie sipas ekspertizës financiare arrin vlerën nga 1,333.710.00 deri 1,647.000.00€, varësisht, cilën ekspertizë e merr për baze, në anën tjetër nëse merret për baze deklarata e palëve të dëmtuara rezulton se përfitimit i supozuar nga vepra penale sipas pikës I në mënyre konkrete arrijnë shumën prej 10,640.00€, kështu dallimi i shumës së parave që supozohet se janë fituar në lartësi prej 10,640.00€, me vlerën 1,333.710.00€ (ose 1,647.000.00€) të pasurisë së propozuar për konfiskim paraqet cenim të rëndë të sigurisë juridik dhe është i pa drejt, në kundërshtim me nenin 277 paragrafi 2 të KPPPK- se.

Ndërkaq vendimi lidhur me dënimin nuk është i drejtë, kështu nëse gjykata e apelit vlerëson se ndonjë vepër penale i pandehuri ka përgjegjësi penale, mbrojtja gjen se gjykata e shkalles së parë nuk ka marr parasysh të gjithë rrethanat lehtësues tek i mbrojturi im, faktin se i njëjti nuk gëzon

një shëndet jo te mirë, është prind i 5 fëmijëve, mbajtës i familjes, bashkëshort, si dhe nuk ka kryer në të kaluarën veprë penale, andaj edhe ka propozuar që të vendoset si në propozim të ankesës së parashtruar me shkrim.

I akuzuari H.P., në ankesën e tij pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është në kundërshtim me të drejtën pozitive të vendit tonë. Duke pretenduar se i njëjti ka pasur leje para luftës që të punoj, dhe nuk ka pasur telashe nga pushteti serb, kurse pas kësaj kohe nuk janë marrë për bazë të gjitha shkresat të cilat i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, ndërkaq komuniteti i shamanzem i ka ndihmuar në blerjen e veturave, pra asnjë nga veprat penale që i bien në barrë ka pretenduar se nuk i ka kryer. I njëjti është deklaruar edhe në emisione të ndryshe se ai nuk është mjek, dhe nuk ka të bëjë me mjekësi apo aktivitete farmaceutike, por ka të bëjë vetëm me një besim, që vetëm lehtëson me lutje, me shkrime, me frymë, si dhe me flaka rituale.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit, analizoi aktgjykimin e ankimuar së bashku me shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet ankimore, dhe sipas detyrës zyrtare, gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara në dispozitën e nenit 384 par.1 pika 1.10 e lidhur me nenin 369 par.7 të KPPRK-së, apo shkelje tjera e të cilët kishin me kushtëzua anulimin e detyrueshme të aktgjykimin. Në dispozitivin e aktgjykimin janë përshkruar në tërësi veprimet inkriminuese të cilët formojnë elementet e veprave penale për të cilin është shpallur fajtor i akuzuari dhe si i tillë është i qartë dhe i kuptueshëm ndërsa në arsyetim janë dhënë arsye të qarta për faktet vendimtare dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike, për të cilat arsye edhe kjo gjykatë i aprovon si të drejta dhe ligjore.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor për sa i përket tejkalimit të aktakuzës, në dëm të akuzuarit e në kundërshtim me nenin 360 par.1 lidhur me nenin 384 par.1 nënpar.1.10 të KPP-ës.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë tejkalimin e aktakuzës në kuptimin objektiv e në dëm të akuzuarit dhe me këtë të ketë vepruar në kundërshtim me nenin 360 par.1 të KPP-së, ngase çështjet e apostrofuara nga mbrojtësit në ankesë si, palët e dëmtuara, kërkimin nga personat e ndryshëm shumat e ndryshme të parave dhe inkriminimin e regjistrimit të biznesit privat dhe më pas, veprën e ndërlidhur penale nga

mashtimi në veprën penale ushtrimi i palejuar i veprimtarisë mjekësore me veprën e pastrimit të parasë. Kjo për faktin se sipas aktgjykimit të ankimuar rezulton qartazi se gjykata nuk ka gjykuar për një ngjarjen tjetër nga ngjarja si në përshkrimin faktik të paraqitur në aktakuzë, pasi që në përshkrim faktik të veprimeve inkriminuese e të akuzuarit nuk ka munguar apo të ketë përfshirë faktet për një kualifikim më të rëndë të veprës penale nga ajo për të cilën e ngarkon aktakuza, por rrjedh qartësisht se, gjykata në këtë përshkrim për veprën penale si në pikën I të dispozitivit ka përfshirë detaje që si të tilla kanë precizuar veprën penale për të cilën e ka shpallur fajtor, ku pasoja e kësaj vepre penale, Ushtrimit të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 262 të KPK-së, është e karakterit abstrakt për rrezikun e shëndetit të njerëzve e jo për personat e përveçëm ndaj të cilëve është ushtruar veprimtaria mjekësore.

Siç rrjedh edhe nga gjendja e vërtetuar faktike i akuzuari këtë veprimtari të kundërligjshme e ka ushtruar për një periudhë më të gjatë kohore dhe në vend të caktuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie të kundërligjshme të veprimtarisë mjekësore, ndërsa në aktakuzë, si përshkruan mbrojtja në ankesë rezulton se, për këta të dëmtuar ka përshkruar mënyrën dhe mjetet se si i akuzuari ka ushtruar veprimin në drejtim të ushtrimit të veprimtarisë së kundërligjshme mjekësore e jo se janë vetëm këta të dy të dëmtuar si pretendon mbrojtja, ngase si u theksua më lartë pasoja e kësaj vepre penale është abstrakte për rrezikun e shëndetit të njerëzve pa kërkuar specifikimin e emrave konkretë për të dëmtuarit ngase për ekzistimin e kësaj vepre penale është irelevante nëse trajtimi ka pasur apo jo sukses në të dëmtuarit konkretë e aq më shumë kur i akuzuari në këtë periudhë të gjatë kohore inkriminuese është vërtetuar se ka trajtuar një numër të madhe të njerëzve të ndryshëm, gjë për të cilën i akuzuari nuk mohon se gjatë kësaj kohe e kanë vizituar personat e ndryshëm por që sipas të akuzuari ai kishte kryer veprimet e ndërlidhur me ata si rrite fetare e jo si e ngarkon aktakuza për veprimtarin e kundërligjshme mjekësore.

Për sa i përket pretendimit ankimor të tejkalimit të shpalljes së aktgjykimit dhe aktgjykimit të përpiluar në raport me lirimin e parcelës si në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa në shpallje ka komunikuar se ka konfiskuar të gjitha pasurit e patundshme dhe jo të tundshme kjo gjykatë këtë pretendim e gjen të pabazuar për faktin se me shqimin në procesverbalin e shpalljes së aktgjykimit, të datës 10.01.2023 si në shkresat e lëndës, nuk vërtetohet si i qëndrueshëm ky pretendim ngase edhe nga procesverbali i shpalljes së aktgjykimit rrjedhë që gjykata e shkallës së parë kishte vendosur për lirimin e pronës në fjalë si në dispozitiv të aktgjykimit e jo si pretendon mbrojtja, pra e njëjta mënyra e vendosjes si në aktgjykimin e përpiluar me shkrim si ajo në procesverbal të shpalljes së aktgjykimit të ankimuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjet e kësaj gjykate.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për faktin se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari H.P është kryes i veprave penale për të cilat është shpallur fajtor.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata e shkallës së parë ka administruar provat në shqyrtim gjyqësor, si ato personale ashtu edhe ato materiale, të përshkruar më hollësisht si në fq 16,17,18,19 dhe 20 të aktgjykimit të ankimuar ku nga këto provat ka vërtetuar se i akuzuari me veprimet inkriminuese si në përshkrim faktik të pikës I të dispozitivit të aktgjykimit ka kryer veprën penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-së, në pikën II, ka kryer veprën penale Mashtrimi në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPK-së, në pikë III, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, dhe si në pikën IV veprën penale Shpërlaja e parave nga neni 308 të KPK-së lidhur me nenin 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në aktgjykimin e ankimuar janë dhënë vlerësimet për rrethanat faktike dhe është shpjeguar se këto rrethana në ndërlidhje me faktet dhe provat e tjera dhe nga tërësia e tyre është nxjerrë përfundimi i drejtë dhe ligjor që dëshmojnë veprimet inkriminuese e të akuzuarit në kryerjen e veprave penale për të cilat është shpallur fajtor andaj, për rrjedhojë edhe Gjykata e Apelit e Kosovës nga arsyet si në vijim në raport me pretendimet e mbrojtjes, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor se veprimtaria e ushtruar nga i akuzuari nuk ishte veprimtari mjekësore por që arsyeja e regjistrimit të biznesit “B” me fjalën Ordinanca ishte që besimi fetar i H.P që përfshin edhe shërimin shpirtëror alternativ ishte dhënia e shërbimeve shpirtërore.

Fillimisht, ashtu si thekson mbrojtja në ankesë nuk kontestohen faktet se i akuzuari nuk ka pasur licencë përkatëse dhe shkollim në lëmin e mjekësisë. Mirëpo, edhe sipas vlerësimit të kolegjit të

kësaj gjykate pretendimet ankimore në këtë drejtim janë të pabazuar ngase nga gjendja e vërtetuar e fakteve, rezulton se i akuzuari në një periudhë të gjatë kohore kishte pranuar personat e ndryshëm, në mesin e të cilëve ishin edhe të dëmtuarit sipas kësaj çështje penale, për të ofruar shërbimet e tij të kundërligjshme mjekësore në shtëpinë e tij dhe dhomat e veçanta dhe të dedikuara për ofrimin e këtij shërbimi, edhe pse i akuzuari nuk posedon kualifikim profesional mjekësor e as licencë përkatës për këtë veprimtari, në format e përshkruar më afër të veprimeve inkriminuese të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, duke qenë se ai kishte reklamuar nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit atij elektronik dhe të shtypit, duke shtypur dhe shpërndarë kartëvizitat me adresë dhe numër të telefonit për kontakt, me konstatimin se shëron këto “s’mundje....,” edhe pse kjo nuk ishte e saktë dhe e vërtetë, pra se ai mund të shëronte këto sëmundje që i vet theksonte, duke dhënë udhëzimet për përdorimin e mjeteve të ndryshme, nëpërmjet të cilëve ai pretendonte se do ti shëronte në aspektin fizik apo mendor, e të cilat këto mjete nuk janë përcaktuar se janë medikamente të cilët shërojnë ndonjë prej atyre sëmundjeve apo nevojave shëndetësore, për të cilat të dëmtuarit kishin menduar se janë duke marrë këtë trajtim mjekësor, e jo se janë duke kryer shërimin shpirtëror alternativ nëpërmjet dhënies së shërbimeve shpirtërore, si pretendon mbrojtja si pretendon mbrojtja.

Gjykata e Apelit rikujton se te vepra penale, Ushtrimi i kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike, pasoja e kësaj vepre penale është abstrakte për shëndetin e njeriut prandaj, nuk është me rëndësi nëse në rastin konkretë ai shërbim shëndetësor ishte i dobishëm apo jo për marrësin e këtij shërbimi.

Është i pabazuar pretendim ankimor se gjykata të ketë konstatuar se regjistrimi i biznesit “Ordinanca” në mënyrë administrative paraqet element të veprës penale nga neni 262 të KPK-së, për faktin se në dispozitiv është paraqitur si përshkrim për të përcaktuar konen dhe vendin ku ka ushtruar këtë veprimtari mjekësore, dhe jo si pretendon mbrojtja që këtë fakt që jetë inkorporuar si element i veprës penale nga neni 262 të KPK-së, ngase si rezulton edhe nga përshkrimi faktik i akuzuari në këtë vend, me seli në rrugën “Jeta e Re” në Prizren, kishte për qëllim që ta ushtronte këtë veprimtari të regjistruar me aktivitet primar ”aktivitetet tjera të shëndeti të njeriut”.

Gjykata e Apelit vlerëson të pabazuar pretendimin ankimor se në këtë çështje penale nuk përmbushen kushtet për institutin e veprës penale në vazhdim, si nga vepra penale nga neni 262 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-së ashtu edhe për veprën penale të mashtrimit nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Kjo Gjykatë gjen se në këtë çështje penale është e pakontestueshme se gjatë kësaj periudhe kohore i akuzuari ka ndërmarrë në vazhdimësi veprimet të njëjta gjegjësisht të ngjashme, si te personat e ndryshëm në drejtim veprës penale të ushtrimit të kundërligjshme të veprimtarisë mjekësore ashtu edhe te të dëmtuarit e veprës penale të mashtrimit, dhe më këtë ka kryer veprat e llojit të njëjtë, ku objekt i veprës penale është i njëjtë, pra për veprën penale si në dispozitiv I shëndeti i njeriut, dhe që këto veprimet i ka kryer në vazhdimësi i akuzuari dhe në të njëjtin vend apo hapësirë, edhe pse ndaj personave-të dëmtuarve të ndryshëm, dhe brenda një periudhe të caktuar kohore e cila karakterizohet me vazhdimësinë e kësaj kohe për veprimet e ndërmarra inkriminuese, duke shfrytëzuar rrethanat gjegjësisht situatat e njëjta në të cilat gjendeshin personat e ndryshëm përfshirë edhe të dëmtuarit e kësaj çështje penale për nevojat e trajtimit të problemeve të tyre shëndetësore si atyre fizike dhe psikike, të cilat i akuzuari i kishte ndërmarrë me dashje direkte dhe qëllimin e njëjtë gjegjësisht përfitimin material, për këto vepra penale.

Andaj, në këtë drejtim edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, duke marrë parasysh se në këtë rast të gjitha këto veprimet e njëpasnjëshme nga i akuzuari janë ndërmarrë-kryer me dashje direkte, pastaj mënyra e njëjtë e veprimeve konkrete, pra me veprim, si dhe përmbushjen e së paku prej dy kushteve si elementet e konstrukcionit të veprës penale në vazhdim, duke qenë se janë përmbushur kushtet të parashikuara sipas pikave dhe atë; 1.2.objekti i njëjtë i veprës penale, 1.3 shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore, 1.4. vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale-ordinanca “B” dhe 1.5. dashja direkte, pa dyshim rrjedh se akuzuari ishte i vetëdijshëm për veprimet e veta në drejtim të veprave penale të ushtrimit të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike dhe të veprës penale të mashtrimit për qëllim të përfitimit, në vazhdimësi nga neni 81 të KPRK-së, andaj, në këtë drejtim pretendimi ankimore se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me të dëmtuar të ndryshëm dhe jo vetëm me një të dëmtuar si kusht për ekzistimin elementeve të veprës penale në vazhdimësi janë të pabazuara dhe si të tilla janë refuzuar ngase me provat e administruara është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit fitohen elementet e veprës penale të kryer në vazhdimësi, gjegjësisht veprën penale Ushtrimit të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 262 par.1 lidhur me nenin 81 dhe të veprës penale të Mashtrimit nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, ashtu si me të drejtë dhe në përputhje me provat e administruara kishte ardhur në përfundim gjykata e shkallës së parë, e për të cilën konkludim pajtohet edhe kjo gjykatë si të drejtë dhe ligjor.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor përkitazi me vërtetimin jo të plot dhe të drejtë të gjendjes faktike në raport me veprën penale të mashtrimit nga neni 335 të KPK-së, me

pretendimin se nga dëgjimi i dëshmitarëve është e qartë se i akuzuari, me të njëjtit me ndërveprim, ka pasur të bëjë me rituale të natyrës fetare, e jo se të njëjtit kanë besuar në aftësitë të tij “mbinatyrore”, por në cilësitë e caktuara të ritualeve dhe ndikimin e këtyre ritualeve në jetën sociale dhe gjendjen shpirtërore të palëve, Kjo ngase nga provat e administruara nga të cilat është vërtetuar gjendja e fakteve rrjedh se i akuzuari me qëllim të realizimit të përfitimit material të dëmtuarit i ka mashtruar me anë të paraqitjes së rreme të faktit se kinse posedon aftësi të jashtëzakonshme, me premtim se shëron sëmundjet e rënda fizike dhe psikike, dhe në këtë mënyrë arrin që ti vë në lajthim lidhur me këtë fakt të dëmtuarit duke i kërkuar që për këto shërbime të paguajnë shumat e ndryshme të parave.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin e mbrojtjes si në ankesë për dispozitivin II të aktgjykimit (veprën penale mashtrimi), se aktivitetet e ndërmarrë nga i akuzuari nuk janë mashtrim por mund të cilëson si ritet fetare, kjo për faktin se, ashtu si me të drejtë ka ardhur në përfundim gjykata e shkallës së parë, e cila në aktgjykimin e ankimuar ka dhënë arsyet e qarta dhe konkrete në raport me këtë veprë penale, rezulton bindshëm se i akuzuari, sidomos nga traskriptet e përgjimeve, ku në mes tjerash, vërtetohet se i akuzuari në bisedë me personat me të cilët ka komunikuar në telefon, *i tregon se është doktor dhe se duhet të shkojë tek klinika e tij,* dhe sidomos edhe nga dëshmitë e dëshmitarit R.L i cili ka dëshmuar *se i akuzuari i ka kërkuar 1000 euro dhe se për 1 ose për 2 vite i ka premtuar që këtë sëmundje (epilepsi nervore) do ta largoj,* dhe nga dëshmitari I.N i cili ka dëshmuar në rrethanat e dërgimit të disa familjeve të ndryshme te i akuzuari për shërim ku të njëjtit kanë paguar shumat e ndryshme të parave si i kishte kërkuar i akuzuari, dhe në këtë mënyrë duke i vënë në lajthim *se kinse ai posedon këto aftësi mjekuese* me qëllim të përfitimit material për vete, ti ketë premtuar dhe bindur se ai do ti shëroj edhe pse i akuzuari ishte i vetëdijshëm se këtë nuk mund të bëjë, por të gjitha këto i kishte ndërmarrë për ti mashtruar të dëmtuarit për qëllimet e përfitimit për vete.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor se nuk është vërtetuar në mënyrë thelbësore se nga cila veprimtari e kundërligjshme apo veprë penale, shumat monetare dhe nga cili person i mashtruar janë përfituar vlerat monetare mbi 1.000.000,00 euro, e cila është deponuar nga i akuzuari, ngase deponimi i parave të pagesë së kredisë nuk e ka bërë me qëllim të fshehjes së origjinës të parave apo si transaksione ekonomike fiktive, por me qëllim të pagesës së kreative.

Kjo për faktin se, gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara dhe të elaboruar si në arsyetim të aktgjykimit për faktet vendimtare për këtë pikë të dispozitivit, ka ardhur në përfundim

të drejtë se nga pasuria e fituar nga vepra penale, Ushtrimit të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 262 par.1 lidhur me 81 të KPK-së, këto mjete nëpërmjet sistem bankar përmes deponimit të të hollave të gatshme me arsyetimin e pagimit të kësteve të kredisë, ashtu që përmes transfereve bankare, dhe përmes pagesave në kesh për asetet e blera, i ka konvertuar në asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, mjetet këto të cilat i ka fituar nga kryerja e veprës penale, andaj kjo gjykatë pajtohet me konkludimin e gjykatës së shkallës së parë se në këtë çështje penale është vërtetuar se i akuzuari në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të ketë kryer veprën penale të pastrimit të parasë për të cilën e ka shpallur fajtor edhe gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit rikujton se për ekzistimin e elementeve të veprës penale të shpëlarjes së parasë nga neni 308 të ndërlidhur me nenin 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit 05/L-096 për parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit kërkon që pasuria e caktuar të burojë nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri e cila fitohet me vepër penale, pra nuk specifikon veprat penale konkret sipas kapitujve të kodit penal, por me një formulim të përgjithshëm kërkon që pasuria të jetë fituar me aktivitet kriminal apo me vepër penale, andaj në këtë drejtim, si pretendon mbrojtja, nuk është se gjykata të ketë tejkalluar aktakuzën me aktgjykimin e ankimuar kur e ka ndërlidhur me veprën penale tjetër nga ajo që ka qenë me aktakuzë, edhe pse nga dispozitivi fillestar i aktakuzës që të dy këto vepra penale ishin në një përshkrim faktik, përkundër se në këtë çështje penale është vërtetuar se i akuzuari ka kryer të dy këto vepra penale, e për derisa është vërtetuar se i akuzuari ka kryer këto dy vepra penale rrjedhimisht këto e bëjnë edhe ekzistimin e aktiviteti kriminal, element qenësor i figurës së veprës penale të pastrimit të parasë.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimet e mbrojtjes në raport me ekspertizën e ekspertit R.F se e njëjta është joprofesionale dhe është provë e papërshtatshme për të vërtetuar origjinën e të hyrave materiale nga i akuzuari, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimua, fq.47-50, ka dhënë arsytet të plotë dhe të qarta me rastin e pranimit të ekspertizës financiare të këtij ekspertit, i cili në mënyrë të detaizuar ka paraqitur si për formën dhe mënyrën e të hyrave e të akuzuarit gjatë periudhës kohore nga përshkrimi faktik i dispozitivit, ku më pas edhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 27.09.2022, 20.12.2022 dhe 26.10.2022, ka sqaruar më hollësisht lidhur me të gjetura gjatë hartimit të ekspertizës dhe konstatimin e bërë mbi bazën e provave të cilat i ka pasur në shikim nga shkresat e lëndës andaj, gjykata mbi bazën e kësaj ekspertize financiare të ekspertit e të ndërlidhur edhe me provat tjera materiale ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe plotë gjendjen e fakteve lidhur me pasurin- objekt

i vlerësimit si pasuri me prejardhje nga veprimet inkriminuese të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj kundërshtimi i mbrojtjes mbi bazën e mos profesionalizimit dhe të papërshtatshmërisë së kësaj prove, e në veçanti se gjatë përpilimit të ekspertizës, eksperti nuk ka siguruar të dhënat nga ATK-ja, është i pabazuar ngase, rrjedh pa dyshim se prova-ekspertiza financiare është marrë në përputhje me dispozitat e kodit të procedurës penale dhe si e tillë i është nënshtruar kundërshtimit të drejtpërdrejtë nga mbrojtja dhe i akuzuari në shqyrtimin gjyqësorë dhe me provat e dorëzuara nga mbrojtja lidhur me dokumentimin e të hyrave nga bizneset tjera që i ka zhvilluar i akuzuari, ku pos tjerash, nga ekspertiza dhe gjatë dëgjimit të ekspertit financiar në seancën e shqyrtimit gjyqësor rrjedh se për biznesin DPH“Urimi” i ka bazuar në të dhënat e Raportit të Departamentit të Hetimeve të ATK-së, andaj mbi bazën e saj gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të së njëjtës dhe duke e ndërlidhur me provat tjera materiale ka ardhur në përfundim të drejtë përkitazi me vlerësimin e prejardhjes së pasurisë së të akuzuarit, objekt i konfiskimit në këtë çështje penale.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor se gjykata e ka bazuar aktgjykimin e saj në provat e papranueshme ku në shqyrtimin gjyqësorë të datës 22.03.2022, ka bërë leximin e deklaratës B K, të dhënë në prokurori dt.07.12.2018, dëshmitari M.K të dhënë në polici dt.22.01.2019, dhe F.C dhënë në polici dt.12.09.2019, duke elaboruar më tutje njoftimin të cilët gjykata i ka komunikuar në seancë lidhur me arsyet e mos prezencës së tyre në shqyrtim gjyqësor, kështu dëshmitari B.K jeton në Zvicër dhe me parashtrere ka njoftuar se nuk mund të marrë pjesë në seancë dhe mbes pran deklaratës së dhënë më 07.12.2018, dëshmitari M.K ka vdekur, ndërsa F.C me parashtrësë ka njoftuar gjykatën se jeton në botën e jashtme dhe se nuk mund të prezantohet, dhe kështu sipas mbrojtjes gjykata ka vepruar në kundërshtim ngase nuk ka ekzistuar pajtueshmëria në mes të palëve për leximin e tyre duke elaboruar më tutje format e deklaratës së dhënë në procedurë penale.

Kjo për faktin se duke marrë parasysh konstatimin si në përshkrimin e pretendimit ankimorë lidhur me arsyen e mos prezencës së dëshmitarëve, të vërtetuar edhe me shikimin në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.03.22, kolegji penale të gjen të pabazuar këtë pretendim ankimorë nga vet arsyet e cekura dhe kushtet ligjore të cilat janë plotësuar për leximin e procesverbaleve të deklarimeve të këtyre dëshmitareve për shkak se, njëri prej tyre kishte vdekur ndërsa ardhja e të tjerëve në seancë gjyqësore ishte e pamundshme për shkak se ishin në botën e jashtme dhe kanë mundur që të paraqiten në gjykatë.

Gjykata e Apelit rikujton se dispozita e neni 335 par.1 pika 1.1 lidhur me 1.4 të KPP-së parasheh mundësin procedurale për leximin e deklaratave të dhënë në procesverbalin mbi deklaratimet e dëshmitareve më parë, ku pika 1.11 e këtij neni parasheh në mënyrë decisive kushtet të cilat duhet të plotësohen për këtë veprim, dhe atë:” *kur personat e marrë në pyetje kanë vdekur, kanë çrregullime ose paaftësi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundje ose shkaqeve të tjera të rëndësishme.*”, dhe 1.4, nëse gjyqtari gjykues ose trupi gjykues është i bindur që janë në përputhje nën pikat e 1.4.1 deri më 1.4.4. të nenit 335 të KPP-së, e që në rastin sipas nën pikës 1.4.3, janë bërë përpjekje të arsyeshme për të siguruar pjesëmarrjen e dëshmitareve, por pjesëmarrja e tyre ishte e pamundshme për shkak qëndrimit të tyre në vendet më të largëta, jashtë Republikës së Kosovës dhe njërit për shkak të vdekjes.

Mirëpo, edhe përkundër kësaj kolegji penal vëren se, në këtë çështje penale, edhe pse këto janë konstatuar në korpusin e prova të kësaj çështje penale nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar nuk rrjedh se mbi bazën e këtyre dëshmimeve të dëshmitareve gjykata të jetë bazuar për të vërtetuar ndonjë fakt apo të jetë marrë si provë e rëndësishme për çështje të vërtetimit të fajësisë së të akuzuarit në këtë çështje penale andaj, duke rikujtuar dhe marrë për bazë dispozitën e nenit 257 par.1 të KPP-së, e cila parasheh:” *Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri apo mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale*”, të rrjedh pa dyshim se në këtë çështje penale aktgjykimi i ankimuar nuk është bazuar dhe dhënë rëndësi vendimtare dëshmimeve të këtyre dëshmitareve andaj, nga të gjitha të cekura si më lartë kolegji penale e gjen të pabazuar pretendimin se aktgjykimi i ankimuar të jetë bazuar në provat e papranueshme në këtë çështje penale.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor se aktgjykimi i ankimuar është bazuar në provë të papranueshme gjegjësisht kontrollin e datës 16.11.2018, me pretendim se është kryer pa nxjerrjen e aktvendimit për fillimin e hetimeve dhe nga procesverbali i datës 16.11.2018, ceket emri i prokurorëve F.K dhe Petrit Kryeziu, në kundërshtim me nenin 103 par.2 dhe 110 par.1 ku nga ky nenë nuk ceket se në kontrollet e bëra pa urdhër të gjykatës bëhet nga prokurori pa pasur aktvendim të KPPK-së.

Bazuar në shkresat e lëndës rrjedh se në këtë çështje gjykata e shkallës së parë me vendimin, PNDR.nr.241/18 të datës 19.11.2018, kishte aprovuar në mënyrë retroaktive lëshimin e urdhrin gojor- kontrolli i pronës-shtëpisë dhe objekteve përcjellës e të dyshuarit të dhënë për kontroll të

datës 16.11.2018, me arsyetim të qëllimit të nevojës urgjente të mbledhjes së provave materiale, e që nga kjo rrjedh se ky urdhër është i ligjshëm dhe ishte lëshuar bazuar në dispozitën e nenit 110 të KPP-së, dhe fakti i prezencës së prokurorit nuk nënkupton, ashtu si pretendon mbrojtja, se këtë kontroll të ketë bërë prokurori por kontrolli ishte zbatuar nga zyrtarët policor të njësiteve përkatëse të Stacionit Policor në Prizren si parashihet me dispozitën e nenit 110 par.3 të KPP-së, andaj në rastet e rrethanave të ngutshme ashtu si parasheh kjo dispozitë, nuk kërkon domosdoshmëri që formalisht të jetë filluar hetimi me aktvendim për fillim të procedurës penale si pretendon mbrojtja, për shkak të rrethanave të ngutshme dhe ekzistimit të rrezikut real për vonesë që mund të rezultojë me humbjen e provave ose rrezik ndaj jetës ose shëndeti të njerëzve, e që ky veprim në kuptim të par.6 të këtij nenit të KPP-së, kishte marrë aprovim retroaktiv gjyqësor të kontrollit, dhe në këtë drejtim edhe provat tjera të pretenduara si të papranueshme, të specifikuara si në fq.47,48 dhe 49 të ankesës, të rezultojnë se janë provat e pranueshme ngase të njëjtat nuk janë marrë në kundërshtim me nenin 111 të KPP-së.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimet ankimore se aktgjykimin e ka bazuar në provat e papranueshme lidhur me mungesën e nënshkrimit të prokurorit në procesverbalet e deklaratave të dëshmitarëve të specifikuara si në fq.49 të ankesës, ngase vërtetësia e tyre dhe atë se çfarë kanë deklaruar dëshmitarët për këtë çështje janë të dëgjueshme edhe në shqyrtimin gjyqësor dhe mbrojtja ishte në pozitë të marrjes në pyetje të dëshmitareve dhe kundërshtimit të tyre me atë se çfarë janë deklaruar në procesverbal para prokurorisë nëse kishte për të konsideruar se mungesa e nënshkrimit kishte për të vënë në dyshim vërtetësinë e deklaratave të tyre para prokurorit në procesverbal të marrjes së deklaratës së tyre.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor për mos dorëzimin e provave materiale, 4 librave me shënime dhe cd-ja me incizimet të paautorizuara dhe mos marrjes së provës relevante sipas mbrojtjes të propozuara në shqyrtim gjyqësor, për faktin se ashtu si mbrojtja në ankesë citon arsyet për të cilat i ka refuzuar, rrjedh se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet konkrete, për të cilat pajtohet edhe kjo gjykatë, si të arsyeshme dhe të bazuar ngase për ato faktet të kontestuar edhe tani me ankesë nga mbrojtja, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj ka dhënë arsyet konkrete mbi bazën e të cilave ka argumentuar dhe ardhur në përfundim për të vërtetuar se me cilat veprimet i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Megjithatë kjo Gjykatë vëren se nga procesverbali i shqyrtimit fillestar të datës 30.10.2020, konstatohet që mbrojtësi i të pandehurit av.Durim Osmani kishte deklaruar se janë pajisur me

shkresat e lëndës nga Prokuroria gjithashtu edhe me aktakuzë dhe në këtë drejtim nuk ka pasur vërejtje apo kërkesë. Në anën tjetër nga aktakuza rrjedh se në propozimin për administrim të provave, ndër të tjera ishte edhe që të lexohen librat e evidencës e të pandehurit dhe të shikohen CD me incizimin e paautorizuara, të sekuestruar nga pajisjet elektronike e të pandehurit. Ndërkaq, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 23.12.2022, rrjedh se mbrojtja, av.Durim Osmani, ka deklaruar se të gjitha provat të propozuara si në aktakuzë i ka pranuar në kuadër të folderave përmes CD-ve, përveç fletoreve që janë propozuar si provë në aktakuzë.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.05.2022, gjatë administrimit të provave, në fq.3, për sa i përket librave të evidencës të cilat i ka mbajtur vet i pandehuri për vitin 97/98, 1998-1999-2000-2001, 2002-2003, 2003, gjykata gjatë administrimit të prova ka sqaruar përmbajtja e tyre duke njoftuar palët drejtpërdrejtë se në këto libra i akuzuari ka shënuar rastet, emrat të njerëzve, vendet prej nga kanë ardhur dhe arsyet e ardhjes, e po ashtu edhe në fq.4 të procesverbalit kishte administrua CD-et me incizimet e paautorizuara nga pajisjet elektronike të pandehurit, ku gjykata ka njoftuar palët se në këto incizimet shihet se i akuzuari e vendos kamerën në vend të përshtatshëm ku nuk vërehet e pastaj e kyç para hyrjes së “pacientëve” dhe pa dije të tyre incizon rrëfimet e tyre më intime dhe sekretet familjare.

Në seancën gjyqësore të datës 01.06.2022, në fq.3, rrjedh se mbrojtësi i të akuzuarit av.Durim Osmani, lidhur me provat e propozuara dhe administruara nga PSRK-ja, ishte deklaruar duke konfirmuar se, *i kam përshkruar me parashtrësën e dt.23.05.2022 dhe 25.05.2022, në fq.5 dhe 6 dhe mbesim pranë kundërshtimeve*, duke i elaboruar verbalisht vetëm këto kundërshtimet për nevoja të gjykatës jashtë procesit.

Andaj, kolegji i kësaj gjykate nga rrjedhja e shqyrtimit gjyqësore të lartë cekuar, vlerëson se për këto provat dhe përmbajtja e tyre ishin zbuluar dhe të ditur për mbrojtjen dhe të pandehurin, pasi që në shqyrtim gjyqësor të njëjtat janë administruar duke u njoftuar përmbajtja e tyre, ku më pas mbrojtja është sqaruar duke i kundërshtuar të njëjta prandaj, në rastin konkret çështja e ngritur nga mbrojtja për mosdorëzimit të tyre në formë të kopjes, nuk e bënë që e aktgjykimi i ankimuar të jetë mbështetur në këto provat si të papranueshme ngase pas administrimit të tyre mbrojtja i kishte kundërshtuar ndërsa gjykata në kuadër të vlerësimit të provave të administruar në shqyrtim gjyqësor në përputhje edhe me provat tjera ka ardhur në përfundim për vërtetimin e gjendjes së fakteve në këtë çështje penale të arsyetuar si më lartë.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor për sa i përket konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me veprën penale me pretendim se vendimi është i kundërligjshëm dhe i

pabazuar në prova, kjo për faktin se në aktgjykimin e ankimuar gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet të mjaftueshme dhe të qarta se mbi bazën e cilave provave është mbështetur dhe vërtetuar se pasuria e konfiskuar është fituar nga veprat penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor dhe lidhur me bazën ligjore për konfiskimin e pasurisë së fituar me veprë penal, bazuar në neni 61 par.1 dhe 2.6 të KPRK-së, për të cilat arsye pajtohet edhe kjo gjykatë si të drejta dhe të bazuara në ligj.

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën e të akuzuarit, edhe pse nuk cek bazën ankimore, vëren se është duke kontestuar vërtetimin jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me pretendim se i njëjti ka pasur leje para luftës që të punoj, dhe nuk ka pasur telashe nga pushteti serb, kurse pas kësaj kohe nuk janë marrë për bazë të gjitha shkresat të cilat i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, ndërkaq komuniteti shamanzem i ka ndihmuar në blerjen e veturave, pra asnjë nga veprat penale që i bien në barrë, ka pretenduar se nuk i ka kryer. I njëjti është deklaruar edhe në emisione të ndryshe se ai nuk është mjek, dhe nuk ka të bëjë me mjekësi apo aktivitete farmaceutike, por ka të bëjë vetëm me një besim, që vetëm lehtëson me lutje, me shkrime, me frymë, si dhe me flaka rituale.

Gjykata e Apelit gjen se ankesa e të akuzuarit H.P është e pabazuar dhe në kundërshtim me gjendjen e vërtetuar të fakteve nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë për faktin se ashtu si është theksuar edhe më sipër lidhur me pretendimet e tij në këtë ankesë e më të zgjeruar dhe të parashtruar nga mbrojtësit e tij, në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka dhënë arsyet të qarta dhe të plotë për vërtetimin e fakteve relevante, të potencuar me ankesë nga i akuzuari, për të cilat arsye ka dhënë gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar e për të cilat arsye pajtohet dhe kjo gjykatë si të drejta dhe të mbështetura në ligj.

Pretendimet për Shkeljet e ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës

Gjykata e Apelit gjen se në këtë çështje penale nuk ka shkelje të ligjit penal. Kjo për faktin se në gjendjen faktike të provuar nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari ngase i njëjti është penalisht përgjegjës ndërsa në anën tjetër nuk ekziston asnjë nga rrethanat të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale e të akuzuarit.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor se në kuptim të nenit 385 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, për veprat penale Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose

farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe veprës penale Mashtrimi në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, është arritur afati relativ dhe ai absolut i parashkrimit të ndjekjes penale.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në këtë çështje penale për këto dy vepra penale nuk është arritur afati relativ/absolut i ndjekjes penale ndaj të akuzuarit për faktin se për parashkrimin në rastet e këtyre veprave penale në vazhdim afati fillon të rrjedh prej ditës kur i akuzuari ka ndërmarr veprimin për veprën penale të fundit të kryer në vazhdimësi.

Nga përshkrimi fakti i veprimeve inkriminuese e të akuzuarit për pikën I të dispozitivit, ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par.1 lidhur me nenin 81, rrjedh të jetë data 29 Korrik 2019. Meqenëse për këtë vepër penale është paraparë dënimi me gjobë apo me burgim deri në 1 vit, e në kuptim të nenit 106 par.1.6 të KPK-së, është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse ka kaluar dy vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një vit burgim ose me dënim me gjobë, ndërsa sipas nenit 107 par.8 të KPRK-së, është përcaktuar se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, rrjedh se për këtë vepër penale nuk ka arritur parashkrimi relativ apo absolut i ndjekjes penale ashtu si pretendon mbrojtja, ngase nuk ka kaluar koha prej 4 vite nga kryerja e kësaj vepre penale ashtu si pretendon mbrojtja duke llogaritur kohën-momentin datën 17.11.2018 kur është marrë aktvendimi për fillimin e hetimeve në këtë çështje penale, ashtu si nuk ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale të veprës penale të mashtrimit nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, për të cilën është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet, e që rrjedh se veprimi i fundit të jetë data si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, pra data 29 Korrik 2019, e për të cilën vepër penale në kuptim të dispozitës së nenit 106 par.1.5 të KPRK-së, është përcaktuar koha që duhet të kaloj 3 vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se 1 vit burgim ndërsa sipas nenit 107 par.8 të KPRK-së, është përcaktuar se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, rrjedh se për këtë vepër penale nuk ka arritur parashkrimi relativ apo absolut i ndjekjes penale ashtu si pretendon mbrojtja, ngase nuk ka kaluar koha prej 6 vite nga kryerja e kësaj vepre penale duke llogaritur si kohën-momentin datën 17.11.2018 kur është marrë aktvendimi për fillimin e hetimeve në këtë çështje penale.

Të gjeturat për vendimin mbi dënimin

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e prokurorisë për një dënim me të ashpër ndërsa ajo e mbrojtësve e të akuzuarit për një dënim më të butë, nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 74 të KPK-së që ndikojnë në ashpërsimin apo zbutjen e dënimit. Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuari ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale pasi që i njëjti është i përgjegjshëm për veprat penale, i aftë për ti kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta, motivin për kryerjen e veprave penale, ka vepruar me dashje dhe qëllim të caktuar për përfitim të vlerave të ndryshme monetare të cilat u ka kërkuar drejtpërdrejt nga të dëmtuarit, intensitetin e rrezikimit apo i dëmtimit të së mirës së mbrojtur, gjykata ka marrë parasysh se me veprimet dhe metodat të cilat i ka përdorur ka rrezikuar shëndetin dhe jetën e shumë personave si dhe ka krijuar problemet familjare, rrethanat në të cilat ka kryer vepra penale, i njëjti një kohë të gjatë ka ushtruar veprimtarin e kundërligjshme, duke e paraqitur veten se ka aftësi të jashtëzakonshme dhe duke e shfrytëzuar gjendjen psikike dhe emocionale të të dëmtuarve i ka vënë në lajthim dhe nxitur që të paguajnë shuma të ndryshme të parave, shkallën e lartë të pjesëmarrjes në veprën penale pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj vepre penale dhe se veprat penale i ka konsideruar si të vet, ndërsa duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit ka gjetur sjelljet e mira dhe korrekte e të akuzuarit në raport me gjykatën dhe palët tjera, moshën e të akuzuarit pasi që i njëjti është i moshës relativisht të shtyrë, andaj duke marrë parasysh të gjitha këto rrethanat të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e prokurorisë se nuk është vlerësuar këmbëngulësia si rrethanë rëndues, sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë pretendime të pa bazuara, për faktin se rrethanat në të cilat thirret prokuroria kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë, janë peshuar në mënyrën e duhur, si të tilla nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai i cili është shqiptuar në raport me peshën dhe mënyrën në të cilën e ka kryer këto vepra penale, ndërsa pretendimet e mbrojtjes se gjykata nuk ka marrë parasysh të gjithë rrethanat lehtësues tek i akuzuari, faktin se i njëjti nuk gëzon një shëndet jo të mirë, është prind i 5 fëmijëve, mbajtës i

familjes, bashkëshort, si dhe nuk ka kryer në të kaluarën veprë penale, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nuk janë rrethanat të cilat janë paraqitur pas shqiptimit të aktgjyimit të ankimuar dhe si të tilla edhe përkundër ekzistimit të tyre nuk janë të asaj natyre që kishin për të justifikuar një vendim tjetër për dënimin, ndërsa për pretendimi për gjendjen shëndetësore jo të mirë, përpos pretendimit, nuk është se e ka argumentuar me ndonjë provë përkitazi me këtë pretendim, prandaj si të tilla të gjitha këto rrethanat e propozuara si në ankesë nuk justifikojnë shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë andaj edhe kjo gjykatë gjen se në rrethanat e tilla të vlerësuar si të drejta dhe ligjore e të gjitha rrethanave nga gjykata e shkallës së parë edhe kjo gjykatë të krijojë bindjen se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenin 41 të KPRK-së, që në të ardhmen të akuzuarin ta parandaloj nga kryerja e veprave penale dhe si preventiv gjenerale për ti përmbajtur personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPRK-së.

GJYKATA E APELIT NË KOSOVË
DEPARTAMENTI SPECIAL
APS.nr. 23/2023, më datë 05.06.2023

Bashkëpunëtori profesional,

Endrit Ajeti

Anëtarët e kolegjit,

Vaton Durguti

Burim Ademi

Kryetari i kolegjit,

Ferit Osmani
